



Republika e Kosovës
Republika Kosova / Republike of Kosovo
Komuna e Dragashit / Opština Dragaš / Dragas Municipality
Zyra e Kryetarit/Kancelarija Predsednika/President office

KUVENDI I KOMUNËS NË DRAGASH

Ne baze të nenit 12, paragrafi 2, shkronja (c), të Ligjit Nr-03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008", nenit 56 të Statutit të Komunës së Dragashit - 01 Nr.06-103/1 të datës 11.09.2008, Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 02/2019, për organizimin dhe bashkëpunimin e Komunave me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e Komunës së Dragashit, Kuvendi i Komunës në Dragash në mbledhjen e mbajtur me datën 29.04.2026 **pas rishqyrtimit të vendimit 01Nr.060/01-2909-2/26 i dt. 26.02.2026** për emërimin e komisionit për udhëheqjen dhe koordinimin e punës në terren për zgjedhjen e Këshillave Lokale, Kuvendi i Komunës miraton këtë:

VENDIM

PËR RISHQYRTIMIN E VENDIMIT 01Nr.060/01-2909-2/26 i dt. 26.02.2026 PËR EMËRIMIN E KOMISIONIT PËR UDHËHEQJEN DHE KOORDINIMIN E PUNËS NË TERREN PËR ZGJEDHJEN E KËSHILLAVE LOKALE

- I. Me këtë vendim rishqyrtohet vendimi 01Nr.060/01-2909-2/26 i dt. 26.02.2026, sipas shkresës së Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal nr.020-182/4 e dt. 03.04.2026.
- II. Emërohet komisioni për udhëheqjen dhe koordinimin e punës në terren për zgjedhjen e këshillave lokale në fshatra, vendbanime dhe lagje urbane në territorin e komunës së Dragashit.
- III. Komisioni sipas pikës I të këtij vendimi përbëhet prej 7 (shtatë) anëtarëve, ku 4 (katër) anëtar janë nga Kuvendi i Komunës, 2 (dy) anëtar nga Ekzekutivi dhe 1 (një) anëtar përfaqësues fshati, vendbanimi, si në vijim:
 - 2.1 Xhyllferie Bahtijari – Beqiri anëtare nga Kuvendi i Komunës,
 - 2.2 Granit Rifaj anëtar nga Kuvendi i Komunës,,
 - 2.3 Uran Halimi anëtar nga Kuvendi i Komunës,
 - 2.4 Ventaza Esati anëtare nga Kuvendi i Komunës,
 - 2.5 Merybe Ramadani anëtare nga Ekzekutivi i Komunës,
 - 2.6 Uzair Hamza anëtar nga Ekzekutivi i Komunës,
 - 2.7 _____ përfaqësues nga fshati apo vendbanimi.
- IV. Kryesues/e i/e komisionit zgjedhet me konsensus të brendshëm të anëtarëve të komisionit.

- V. Komisioni është përgjegjës për caktimin e periudhës kohore të mbajtjes së zgjedhjeve për anëtar dhe kryetar të këshillave lokale të fshatrave, vendbanimeve në komunën e Dragashit.
- VI. Komisioni ka për detyrë që nëpërmjet mjeteve të informimit, web faqes së komunës, tabelave të shpalljeve, objekteve publike, dhe hapësirave të frekuentuara dhe platformave të tjera të komunikimit të informojë qytetarët 15 ditë para datës së mbajtjes së takimit me qytetarë për zgjedhjen e këshillave lokale.
- VII. Komisioni ka për detyrë që të mbajë procesverbal për çdo takim me qytetarë dhe i njëjti duhet të përmbajë datën, orën dhe vendin e mbajtjes së takimit, numrin dhe listën e pjesëmarrësve dhe i njëjti të nënshkruhet nga kryesuesi i takimit.
- VIII. Obligohet komisioni që punët të i kryej duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ (MAPL) Nr.02/2019 për organizimin, funksionimin dhe bashkëpunimin e komunave me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane.
- IX. Vendimi, hyn në fuqi 30 ditë pas dërgimit në organin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 8 dhe nenit 9 të Ligjit Nr.08/L-284, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 24/2024'' dhe pas publikimit në tabelën e shpalljeve dhe faqen zyrtare të Komunës.

Shtojcë: 1. Vendimi 01Nr.060/01-2909-2/26 i dt. 26.02.2026,
2. Shkresa e MAPL-së nr.020-182/4 e dt. 03.04.2026

01Nr. 060/01-6556-1/26
Datë 29.04.2026

